



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA E KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA-SHTIME/OPŠTINA-ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Zyra e Kryetarit të Komunës
Kancelaria Predsednika Opštine/Mayor's Office

Datë: 22/10/2025

Nr. 02/1220

Në mbështetje të neneve, 13, 17, 24 dhe 58 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, sipas nenit 19 të Rregullores nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurive Jofinanciare në Organizata Buxhetore, Kryetari i Komunës merr

V E N D I M

1. Formohet Komisioni për inventarizimin e pasurisë jofinanciare për vitin 2025 për njësinë buxhetore - Administrata Komunale.
2. Anëtarët e komisionit sipas pikës I të dispozitivit caktohen:
 - I. Skender Dauti - kryesues
 - II. Gonxhe Osmani - anëtare.
 - III. Sadbere Halili - anëtare.
3. Detyrat dhe përgjegjësitë e anëtarëve të Komisionit janë të bazuara në legjislacionin në fuqi dhe zhvillohen në pajtim me Rregulloren nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jofinanciare në Organizata Buxhetore.
4. Konkretisht, detyrat dhe përgjegjësitë sipas pikës paraprake të dispozitivit përfshijnë:
 - a. Inventarizimin e të gjithë pasurisë jofinanciare që është në pronësi dhe nën kontroll të komunës së Shtimes;
 - b. Verifikimin fizik dhe cilësor të gjendjes së pasurisë jofinanciare;
 - c. Krahasinin e gjendjes faktike të inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurisë jofinanciare;
 - d. Identifikimin e pasurive që mungojnë, dëmtuar apo janë të papërdorshme për arsye të ndryshme;
 - e. Përgatitjen e raportit për procesin e inventarizimit;
 - f. Hartimin e raportit të përgjithshëm në bazë të raporteve individuale të Komisionit për Inventarizimin e Pasurive Jofinanciare deri më 10/01/2026.
5. Raportet dhe dëshmitë e procesit duhet të dorëzohen te Komisioni Komunal për Inventarizim që të përgatidet Raporti Përfundimtar i Pasurisë Jofinanciare.
6. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrim.

Ju dërgohet:
Anëtarëve të Komisionit
Arkivit



Kryetari i Komunës

Demaj Aliu